

KONTRATË DHURIMI KUOTASH

Sot me datë 03.03.2021 (dymijë e njëzetnjë), në zyrën qendrore të shoqërisë “**ALS Engineering Construction**” sh.p.k, në adresën Rr.“Abdyl Frashëri”, Pall.Jeshil, pranë Vesa Center, Kati 8-të, Tiranë, u lidh kjo Kontratë Dhurimi (e cila në vijim do të emërtohet “Kontrata”)

DHURUESI/IA:

znj.Alba Hasa, atësia Ismet, amësia Vjollca, shtetase shqiptare, banuese në adresën Blv “Zhan D’Ark”,Tiranë, lindur më 29/07/1987, madhore me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit (ID) nr.033268809 dhe nr.personal I75729051E
(këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si “*Dhuruesi/ia*”).

PRANUESI I DHURIMIT:

z.Stiven Kola, atësia Agim, amësia Elida, shtetas shqiptar, banues në adresën Rr.Mujo Ulqinaku Nd.75, Durrës, lindur më 15/09/1989, madhor me zotësi të plotë juridike për të vepruar, identifikuar nëpërmjet letërnjoftimit (ID) nr.034925116 dhe nr.personal I90915063B
(këtu e më poshtë, për efektet e kësaj kontrate referuar si “*Pranues Dhurimi*”).

Baza Ligjore:

Ligji nr.9901 dt 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i përditësuar.
Ligji nr.9723 dt. 03.05.2007“Për Qendrën Kombetare të Regjistrimit”, i përditësuar.
Kodi Civil Shqiptar (Neni 761, 762, 764 e vijues i tij).

Kushtet paraprake:

- i. Dhuruesi/ia është ortak me numrin e pjesëve 1 (një) dhe pjesëmarrje në përqindje 20 % (njëzet përqind) në shoqërinë “**ALS Engineering Construction**” sh.p.k, e regjistruar rregullisht si person juridik me datë 10/02/2017, pranë QKB (Qendrës Kombëtare e Bisnesit), me **NUIS: L71410038G**, me zyrë qendrore në adresën Rr.“Abdyl Frashëri”, Pall.Jeshil pranë Vesa Center, Kati 8-të, Tiranë-Shqipëri.
- ii. Në zbatim, të Nenit 7- Transferim i kapitalit të Statutit të shoqërisë dhe Ligjit nr.9901 dt. 14.4.2008 “Për tregtarët dhe shoqëritë tregtare”, i përditësuar, pjesët e kapitalit themeltar të shoqërisë me përgjegjësi të kufizuar, janë lirisht të transferueshme ndërmjet ortakëve, për sa nuk parashikohet ndryshe në statutin e shoqërisë.



- iii. Dhuruesi/ia pjesën e saj nominative 20% (njëzet përqind), që zotëron në shoqërinë “ALS Engineering Construction” sh.p.k, dëshiron t’ia dhurojë z.Stiven Kola, në përputhje me kushtet e parashikuara në kërë kontratë.
- iv. Pranuesi i Dhurimit, i cili do të pranojë dhurimin e pjesës që i korrespondon 20% (njëzet përqind) të pjesëmarrjes në përqindje, që dhuruesi/ia zotëron në shoqërinë “ALS Engineering Construction” sh.p.k, në përputhje me kushtet e parashikuara në këtë kontratë.

Dhuruesi dhe Pranuesi i Dhurimit, janë referuar më poshtë individualisht si “Pala” dhe sëbashku si “Palët”.

Neni 1 Objekti i Kontratës



1.1 Dhuruesi/ia dëshiron të dhurojë në këtë kontratë me vullnet të lirë e të plotë në përputhje me Kodin Civil të Republikës së Shqipërisë, Ligjit 9901 date 14.04.2008 “Për Tregtarët dhe Shoqëritë Tregtare” (i ndryshuar) dhe Statutit të Shoqërisë, kapitalin që zotëron për pjesën e saj, me vlerë nominale prej 20,00 (njëzet) lek dhe pjesëmarrje në përqindje 20 % (njëzet përqind), që dhuruesi/ia zotëron në shoqërinë “ALS Engineering Construction” sh.p.k

1.2 Dhuruesi/ia, duhet të përfundojë dhe dorëzojë dhe/ose të bejë të mundur përfundimin dhe dorëzimin e dokumentave të tjerë të nevojshëm sipas legjislacionit shqiptar, në menyrë që t’i kalojë Pranuesit të Dhuruesit një titull të tregtueshëm mbi pjesën e kapitalit dhe për të përmbushur siç duhet qëllimin e kësaj Kontrate.

1.3 Dhuruesi/ia dhe Pranuesi i Dhurimit, bien dakort për të përfunduar dhe dorëzuar me kërkesë të palës tjetër dhe/ose Shoqërisë, çdo dokument të nevojshëm për të regjistruar 20 % (njëzet përqind) të pjesëmarrjes në përqindje të numrit të pjesës në zotërim të Pranuesit të Dhurimit, subjekt të kësaj Kontrate në Regjistrin Tregtar të Qendrës Kombëtare të Bisnesit dhe të autoriteteve shqiptare të kërkuara sipas legjislacionit Shqiptar.

Neni 2 Deklarimet dhe Garancitë e Dhuruesit

2.1 Dhuruesi/ia, deklaron se me nënshkrimin e kësaj kontrate dhe regjistrimin në Qendrën Kombëtare të Bisnesit (QKB), humbet cilësinë e ortakut në shoqëri për rrjedhim humbet të drejtën e zotërimit të pjesës së saj, me pjesëmarrje në përqindje 20% (njëzet përqind), pasi këto të drejta i transferohen Pranuesit të Dhurimit, i cili fiton të drejtën e zotërimit të pjesës, me pjesëmarrje në përqindje 20% (njëzet përqind), të kapitalit të shoqërisë.



2.2 Me nënshkrimin e kësaj kontrate dhurimi, shoqëria "ALS Engineering Construction" sh.p.k, bëhet me një ortak të vetëm, kapitali i së cilës është nënshkruhet dhe zotërohet nga:

-Z. Stiven KOLA, i cili do të zotërojë 100% (njëqind përqind) të numrit të pjesës së shoqërisë të cilat korrespondojnë me 1.00 (një) numër pjesësh, me vlerë nominale në para 100.00 (njëqind) Lekë, të kapitalit themeltar të shoqërisë.

Neni 3

Deklarimet dhe Garancitë e Pranuesit të Dhurimit

3.1 Pranuesi i Dhurimit, i bën deklaratimet dhe i jep garancitë e mëposhtme Dhuruesit/ses, secila prej tyre do të jetë e vërtetë dhe e saktë.

3.2 Autorizimi – Të gjitha veprimet, aktet dhe/ose procedurat e tjera të parashikuara nga legjislacioni shqiptar dhe / ose aktet e Shoqërisë që duhet të ndërmerren nga ose për llogari të Dhuruesit/ses dhe që autorizojnë Dhuruesin/en të lidhë dhe të zbatojë këtë Kontratë janë kryer rregullisht.

3.3 Kjo Kontratë është nënshkruar dhe dorëzuar rregullisht nga Dhuruesi/ia dhe përbën një detyrim të vlefshëm dhe ekzekutiv për Pranuesin e Dhurimit që duhet zbatuar prej tij, në përputhje me kushtet dhe afatet e Kontratës.

Neni 4

Të ndryshme

4.1 Çdo shtesë, ndryshim, zgjidhje ose heqje dorë nga ndonjë prej dispozitave të kësaj Kontrate, do të jetë e vlefshme vetëm nëse bëhet me shkrim, me akt noterial dhe nënshkruhet nga ose në emër të secilës Palë.

4.2 Në rast se një dispozitë ose detyrim sipas kësaj Kontrate është i pavlefshëm, i paligjshëm ose i pazbatueshëm në një juridiksion, vlefshmëria, ligjshmëria dhe zbatueshmëria e dispozitave ose detyrimeve të tjera, ose e këtyre dispozitave ose detyrimeve në një juridiksion tjetër, nuk do të preket nga një fakt i tillë.

4.3 Palët do të përpiqen të zëvendësojnë një dispozitë të pazbatueshme ose të pavlefshme, në masën më të madhe të mundshme, për të arritur qëllimin e kësaj dispozitë .

Neni 5

Ligji i zbatueshëm dhe juridiksioni kompetent

5.1 Kjo Kontratë rregullohet nga legjislacioni Shqiptar në fuqi.



5.2 Çdo konflikt në lidhje me nënshkrimin, interpretimin, zbatimin Kontratës do të zgjidhet nga juridiksioni kompetent gjyqësor Shqiptar.

Kontrata e Dhurimit të Kuotave, u lexua nga palët të cilët deklarojnë se e kuptuan përmbajtjen e saj dhe meqenëse ajo shpreh vullnetin e tyre të lirë e të plotë, u njohën dhe i kuptuan efektet e saj juridike, e nënshkruajnë atë rregullisht.

Kontratë dhe nënshkruhet në 3 (tre) kopje origjinale në gjuhën shqipe dhe përbën marreveshjen e plotë midis Palëve për çdo aspekt që lidhet me objektin e kësaj.

Bashkëlidhur kontratës, gjendet dokumentacioni i mëposhtëm:

- *Kopje e mjeteve të identifikimit të palëve.*
- *Statuti shoqërisë "ALS Engineering Construction" sh.p.k.*
- *Vendim i asamblesë së përgjithëshme.*

PALËT

DHURUESI/IA

Ortaku

zj.Alba HASA

Alba Hasa



PRANUES DHURIMI

Ortaku

z.Stiven KOLA

Stiven Kola

